



KËRKESË

Nr. 5945, datë 24.4.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“ELVISI-03”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“ELVISI-03”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË ISHMPUT,
DEGA TIRANË
Elvisjon Salke

VENDIM

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2 të nenit 51 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM Nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 5 datë 23.4.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“Elvis – 03 sh.p.k.”**, protokolluar me nr. 2323 prot. datë 14.5.2018

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 5, të nenit 62, të ligjit 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 5 datë 23.4.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 1500000 lekë, pezullimin plotësisht të aktivitetit dhe rrëzimin e ankimit të subjektit **“Elvis – 03 sh.p.k.”** ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

